

FORMULARI PROJEKT PROPOZIMIT TË PLOTË

SEKSIONI I – INFORMACION I PËRGJITHSHËM I APLIKANTIT

| | |
|---|--|
| Emri i Aplikantit | QENDRA PËR PROGRES RINOR |
| Titulli i Projektit të Propozuar | Shëtis, fotoqafoj, pastroj! Aktivizim qytetar përgjatë rrugëve rurale të Parkut Natyror Korab-Koritnik për t'a mbrojtur nga degradimin mjedisor |
| Drejtimi i Thirrjes | Drejtimi 1 |
| Personi i kontaktit | Rifat Demalija |
| Adresa e e-mailit Adresa e ëbfaqes Adresa postare | orgcyp@hotmail.com www.cyp.al Rr. Nënë Tereza, L 5, Godinë Private |
| Numri i telefonit | 0674777423 |
| Buxheti total i projektit në Franga Zviceriane (CHF) | 36,440 |
| Shuma e kërkuar nga LANë (CHF) | 35,000 |
| Informacion për bashkëfinancim | Qendra për Progres Rinor është bashkëfinancuese nga burime të veta |
| Partnerët e Projektit | |
| Kohëzgjatja e Projektit | 12 muaj |
| Misioni i aplikantit (organizatë/grup informal) | Avokim dhe lobim për politika efektive për çështje rinore, përfshirjen e të rinjve në zhvillimin e programeve vendore dhe qeverisjes së mirë & përfshirja rinore në zhvillimin mjedisor. |
| Përfaqësuesi ligjor. e-mail, Numri i telefonit: | Rifat Demalija rifat.demalija@gmail.com 0674777423 |
| Nisma të ngjashme të ndërmarra më parë. | Aktivitete vullnetare dhe partneriteti |
| Përvoja të mëparshme LA | N/A |

SEKSIONI II– PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT TË PROPOZUAR

| | |
|--|---|
| Emri i Aplikantit | QENDRA PËR PROGRES RINOR, Kukës |
| Titulli i Projektit të Propozuar | Shëtis, fotoqrafoj, pastroj! Aktivizim qytetar përgjatë rrugëve rurale të Parkut Natyror Korab-Koritnik për t'a mbrojtur nga degradimin mjedisor. |
| Arsyetimi i Propozimit (i përmbledhur) | Rrjedhat ujore përgjatë rrugëve të fshatrave të Parkut Natyror Korab-Koritnik në territorin e Kukësit janë në rrezik të madh nga ndotja, për shkak të hedhjes vend e pa vend të mbeturinave, burimeve të kufizuara nga autoritetet vendore, mungesa e vetëdijes dhe vlerësimit mjedisor nga komuniteti pasiv. |
| Qëllimi dhe objektivat specifike | <p>Qëllimi: Edukim dhe aktivizim qytetar për të bashkërenduar një proces gjithëpërfshirës në menaxhimin e mbetjeve dhe minimizuar degradimin mjedisor përgjatë rrugëve dhe rrjedhave ujore në zonat rurale pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik në 4 Njësi Administrative, Bashkia Kukës.</p> <p>Objektivat specifike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rrisim aktivizimin qytetar, përmes ngritjes së 4 grupeve të ‘Ambasadorëve të Natyrës’ në shkollat e mesme, dhe përfshirjen e 10 grupeve komunitare në konsultime me njësitë e qeverisjes vendore për zhvillimin e planit të veprimit për menaxhimin e mbetjeve. - Përfshirja e grupeve rinore, banorëve (gra & burra) dhe autoriteteve vendore në edukimin mjedisor, përmes pilotimit të 1 fshati, për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në mënyrë periodike për një periudhë 1 mujore dhe vazhdimësinë e praktikës nga ana e njësisë së qeverisjes vendore. - Rrisim edukimin mjedisor dhe përgjegjshmëri komunitare, përmes mobilizimit vullnetar komunitar në pastrimin e 5 pikave të nxehta të mbetjeve, duke promovuar natyrën dhe zhvillimin e turizmit malor. |
| Aktivitetet kryesore | <ol style="list-style-type: none"> 1. Sesione informuese, eksplorojmë mënyrat inovative për të mbrojtur natyrën 2. Krijim i grupeve Ambasadorët e Natyrës në 4 shkollat e mesme 3. Cikël me 4 Workshope për edukimi mjedisor për ‘Ambasadorët e Natyrës’ 4. Fotoqrafi dhe identifikim i pikave të nxehta në 18 fshatra 5. Ekspozitë virtuale për pikat e nxehta dhe promovim i natyrës 6. Aksione vullnetare, pastrim mbeturinash & promovim natyrës 7. Monitorim dhe publikim i një raporti për menaxhimin e mbetjeve 8. Pilotim për grumbullimin dhe evadimi i mbetjeve, në fuksion të ndërgjegjësimit, partneritetit dhe aktivizimit qytetar për menaxhimin e mbetjeve, fshati Mustafaj, për 1 muaj 9. Plan veprimi për vazhdimin e projektit dhe menaxhimin e mbetjeve 10. Workshop përmbyllës me bashkëpunorët e projektit 11. Fushatë ndërgjegjësuese për politikën zhvillimore në mbrojtjen e mjedisit |
| Rezultatet e pritshme | <ul style="list-style-type: none"> - Reagim konkret nga grupet rinore për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit - 4 NjQV konsultohen me grupet komunitare duke respektuar përfshirjen gjinore |

| | |
|---|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Grupet rinore të fuqizuara dhe aktive në aspektin e mbrojtjes së mjedisit - 16.000 banorët e zonës të vetëdijshëm për mbrojtjen e mjedisit - Pastrimi i 5 hot-spotëve dhe pilotim 1 fshatrave për menaxhim e mbetjeve - Reduktim i ndotjes me 80% në zonë dhe promovimi i historive të suksesit - Plan veprimi për vazhdimin e aktiviteteve të projektit |
| Përfituesit kryesorë | Banorët e 18 fshatrave përgjatë rrugëve rurale; 4 NjQV Shishtavec, Topojan, Zapod dhe Bicaj, Bashkia Kukës; nxënësit e 4 shkollave të mesme, Agjencia e zonave të mbrojtura, dhe aktorët e shoqërisë civile të lidhur me ambjentin. |
| Shuma e kërkuar Franga Zviceriane (CHF) | 35,000 |
| Kohëzgjatja e projektit (muaj) | 12 muaj |
| Zona e zbatimit | Bashkia Kukës, NjQV-të: Shishtavec, Topojan, Zapod dhe Bicaj |
| Grupi i punës | Rifat Demalija, Eris Zenelaj, Lavdrim Shehu, Besjana Gjermiza, Shpetim Dulla, Brusilda Kastrati |
| Përfaqësuesi ligjor (për OJF-të) | Rifat Demalija |
| Partnerët në projekt | NA |

SEKSIONI III –PËRSHKRIM I DETAJUAR I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1 TITULLI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.2 Përshkrimi i situatës dhe arsytimi i propozimit (maks.1 faqe).

Rrjedhat ujore të fshatrave pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik në territorin e Kukësit janë në rrezik të madh nga degradimi mjedisor¹. Hedhja vend e pa vend e mbeturinave përgjatë rrugëve, burime të kufizuara dhe menaxhimi i dobët nga autoritetet vendore, sikurse mungesa e vetëdijes dhe vlerësimit mjedisor nga komuniteti pasiv, po ndikon në ndotjen e ujit, ekosistemin, dëmtim dhe pengim të zhvillimit të turizmit malor².

Mungesa e vend-grumbullimeve të mbeturinave³ përgjatë rrugëve të 18 fshatrave të zonës, ka krijuar një kulturë ‘të pranueshme’ për banorët në hedhjen e mbeturinave përgjatë rrugëve, përrrenjëve apo lumenjve, duke krijuar jo vetëm një pamje të shëmtuar, por duke dëmtuar cilësinë e ujit të pijshëm, speciet e rralla dhe jetën e banorëve përgjatë këtyre zonave⁴.

¹<https://www.youtube.com/watch?v=mOOZ09Sr IE>

²<https://top-channel.tv/2021/06/19/kukesi-ne-emergjence-mjedisore-plehrat-grumbullohen-ne-ane-te-liqenit-ndotje-e-madhe-edhe-prane-fshatrave/>

³<https://faktoje.al/landifilli-i-ri-rajonal-i-kukesit-nje-premtim-ne-leter/>

⁴<https://www.dailymotion.com/video/x3fjms3>

Nga vlerësimi i nevojave në terren gjatë përgatitjes së projektit, kemi konstatuar se banorët e zonës dhe autoritetet vendore nuk kanë asnjë plan për menaxhimin e mbetjeve në zonat rurale, ndërkohë që vetë banorët e fshatrave nuk kanë ndërmarrë asnjë iniciativë për të pastruar mbetjet apo për t'u konsultuar dhe gjetur zgjidhje për ndotjen e natyrës.

Pavarësisht se zona ku do të zhvillohet ky projekt është Park Natyror dhe shumë atraktive për turistët, mbetjet përgjatë rrugëve të hedhura nga vetë banorët po e dëmtojnë natyrën dhe pengojnë zhvillimin turizmit. Një pjesë e madhe e mbetjeve përgjatë rrugëve rurale, zhvendosen nga rrjedhat e ujit për në Liqenin e Fierzes⁵ duke krijuar një degradim mjedisor dhe kërcënim për gjallesat ujore.

Rreziqet e ndotjes për shkak të përdorimit të materialeve të rrezikshme dhe hedhjes së tyre përgjatë rrugëve rruale apo në rrjedhje të përrenjve/lumenjve, mund të parandalohen me koordinimin dhe gjithëpërfshirjen në edukimin dhe aktivizimin e gupeve rinore dhe banorëve të zonës (gra & burra), operatorëve turistikë, autoriteteve vendore dhe shoqërisë civile.

Fotografimi dhe inventarizimi i të gjitha pikave të nxehta dhe promovimi i natyrës, plani i veprimit konsultuar nga autoritetet vendore me gra dhe burra të zonës, aktivitetet vullnetare për pastrimin e mbetjeve me përfshirjen e grupeve rinore lokale, aktivistët e shoqërisë civile dhe operatorët turistikë për pastrimin e mbeturinave përgjatë rrugëve në bashkëpunim me autoritetet vendore, (NjQV-të dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike), duke angazhuar rregullisht 2-3 ditë në muaj anëtarët e komunitetit që mbështeten përmes skemës së Ndihmës Ekonomike, do të edukojë komunitetin dhe parandalojë degradimin mjedisor të Parkut Natyror Korab-Koritnik.

Zona e pilotuar nga ky projekt, përfshin katër njësi administrative, katër shkolla të bashkuara, (të mesme dhe 9-vjecare), të cilat do të përfshihen në aktivitetet edukuese dhe vullnetare, me një potencial të jashtëzakonshëm për të ndryshuar situatën dhe gjetur zgjidhje inovative për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrotjen e natyrës.

Projekti është drejtëpërdrejtë i lidhur dhe shumë i përshtatshëm me drejtimin e I-rë, duke qenë se në fokusin kryesor ka mobilizimin qytetar në mbrotjen e mjedisit si një çështje me interes për vetë komunitetin, duke marrë në konsideratë perspektivën gjinore, pasi gratë dhe vajzat do të jenë pjesë në të gjitha takimet konsultuese dhe monitoruese për t'u bërë pjesë e zgjidhjes së problemit.

2.3 Qëllimi dhe objektivat specifike të projektit të propozuar (maks. 1 faqe).

Qëllimi: Edukim dhe aktivizim qytetar për të bashkërenduar një proces gjithëpërfshirës në menaxhimin e mbetjeve, dhe minimizuar degradimin mjedisor përgjatë rrugëve dhe rrjedhave ujore në zonat rurale pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik në 4 Njësi Administrative: Shishtavec, Topojan, Zapod dhe Bicaj, pjesë e Bashkisë Kukës.

Objektivat specifike:

- Rrisim aktivizimin qytetar, përmes ngritjes së 4 grupeve të 'Ambasadorëve të Natyrës' në shkolla dhe përfshirjen e 10 grupeve komunitare në konsultime me njësitë e qeverisjes vendore për zhvillimin e planit të veprimit për menaxhimin e mbetjeve si vlerë e shtuar e projektit.
- Përfshirja e grupeve rinore, banorëve (gra & burra) dhe autoriteteve vendore në edukimin mjedisor, përmes pilotimit të fshatit Mustafaj (pjesë e NjQV Bicaj), për grumbullimin dhe

⁵<https://shqiptarja.com/lajm/nis-pastrimi-i-liqenit-te-kukesit-nga-mbeturinat-ministri-klosi-aksioni-shqiperikosove-na-bashkon-me-shume>

transportimin e mbeturinave në mënyrë periodike për një periudhë 1 mujore dhe vazhdimësinë e praktikës nga ana e njësisve të qeverisjes vendore.

- Rrisim edukimin mjedisor dhe përgjegjshmëri komunitare, përmes aksioneve konkrete, mobilizimin vullnetar komunitar në pastrimin e 5 pikave të nxehta të mbetjeve (Shtrezë, Orçikël, Topojan, Mustafaj dhe kryqëzimi për tek Stani Hoxhës), duke promovuar natyrën dhe zhvillimin e turizmit malor.

2.4 Metodologjia dhe aktivitetet

a) **Metodologjia** që do të zbatohet për arritjen e rezultateve. *Si do të vepohet dhe çfarë mjetesh janë të nevojshme për realizimin e aktiviteteve.*

Metoda e zbatimit të projektit mbështetet në praktikën më të mira që ne kemi zbatuar me projekte të mëparshme, duke kontribuar në arritjen e rezultateve dhe krijimin e një qasje ambjentaliste për grupet e synuara.

Projekti implikon zbatimin e metodave të ndryshme si vijon

- përfshirje e barabartë djem & vajza, në aktivitete, në planifikim, monitorim dhe vlerësim.
- anëtarët e grupeve ‘Ambasadorët e Natyrës’ me balancë gjinore organizojnë shëtitjet dhe fotografim të situatës së pikave të nxehta dhe promovim të natyrës
- aktivitete me ‘Ambasadrët e Natyrës’ për të nxitur edukim mjedisor dhe aktivizim
- takime konsultuese me drejtuesit e NjQV-ve për të bashkëndëruar planin e veprimit për menaxhimin e mbetjeve si vlerë e shtuar e projektit;
- daljet në media, shkrimet dhe publikimet nga gazetarët vendor
- komunikim me publikun dhe mobilizimi qytetar për pjesëmarrje në aktivitetet vullnetare
- takime të përbashkëta midis përfqësuesve të 4 NjQV dhe drejtuesve të 10 fshatrave për të hartuar një Plan Veprimi për menaxhimin e mbetjeve dhe vazhdimin e projektit
- përfshirja e të rinjve në aktivitetet promovuese, kryesisht në rrjetet sociale
- zhvillimin e iniciativave të përbashkëta, grupe rinore, grupe komunitare dhe autoritetet vendore
- pyetësorë para dhe pas aktiviteteve për të vlerësuar ndryshimin njohurive tek pjesëmarrësit
- zhvillim i planit të monitorimit dhe ndarja rezultateve të raportit të vlerësimit me aktorët vendor

b) *Si mendoni të realizoni promovimin dhe vizibilitetin e projektit tuaj lidhur me aktivitetet, produktet dhe rezultatet e arritura?*

Bashkia Kukës me 4 NjQV-të, 4 shkolla të bashkuara, (të mesme dhe 9-vjecare), dhe media lokale, janë bashkëpunorë të rëndësishëm për të siguruar shikueshmëri të lartë në nivel lokal.

Bazuar në përvojat e mëparshme, ne e kemi konsultuar paraprakisht me aktorët e medias vendore idenë e projektin dhe interesi tyre është të përfshihen si bashkëpunor që ndihmon në edukimin e publikut dhe advokues për çështjen e mjedisit përmes edicionit të lajmeve dhe programeve speciale. Paraprakisht, kemi rënë dakort të bashkëpunojmë me gazetarë vendor të medias publike si; Radio Kukës & TVSH Kukës për të publikuar aktivitetet dhe monitorimin e situatës në terren, përgatitjen e komunikimeve me publikun dhe mbajtjen e disa edicioneve të posacme me qëllim për të edukuar publikun në masë të gjerë dhe arritur shikueshmërinë e të paktën 25,000 njerëz në rajon.

Do të prodhohen flyers me aktivitetet dhe informacionet e projektit, por do të shmangim në maksimum printimin, duke u fokusuar tek forma elektronike e shpërndarjes së informacionit përmes rrjeteve sociale.

Një ekspozitë virtuale do të shfaqet përgjatë projektit, për të ndikuar tek autoritetet vendore dhe komuniteti në terësi në edukimin për mjedisin. Një banderolë (Roll-up) me një mesazh dhe logo të dedikuar për projektin do të përdoret në rrjetet sociale online dhe offline në të gjitha aktivitetet.

Do të nxisim grupet rinore, sidomos ‘Ambasadorët e Natyrës’, që të shpërndajnë të gjitha aktivitetet në rrjetet sociale të organizatës. Ne gjithashtu kemi një webfaqe: www.cyp.al dhe faqen tonë në facebook dhe Instagram me më shumë se 4900 ndjekës, të cilat do ti përdorim për të publikuar aktivitetet, produktet dhe gjetjet nga projektin.

c) **Aktivitetet:** Çfarë aktivitetesh planifikoni me qëllim arritjen e rezultateve të pritshme?

1.1.10 Sesione informuese një ditore me 8-12 pjesëmarrës (përfshirje e barabartë, burra & gra) me autoritetet vendore, banorët e fshatrave (secili fshat në vete) dhe grupet rinore për informim për projektin dhe për gjetjen e mënyrave inovative për të mbrojtur natyrën

1.2. Takime 1 ditore për ngritjen grupeve ‘Ambasadorët e Natyrës’ në 4 shkollat e mesme, me 10-12 pjesëmarrës të moshës 14-16 vjeç, duke respektuar barazinë gjinore.

1.3. Cikël me 4 workshope 2 ditore për fuqizim dhe edukimi mjedisor për ‘Ambasadorët e Natyrës’, për të marrë pjesë në mbrojtjen e mjedisit dhe planet zhvillimore vendore, me 10-12 pjesëmarrës të moshës 14-16 vjeç dhe një mësues koordinator.

1.4. Fotografim, identifikimi dhe inventarizimi i pikave të nxehta të mbetjeve përgjatë rrugëve rurale. 4 Shëtitje një ditore në natyrë me ‘Ambasadorët e Natyrës’ të koordinuara për të vizituar 18 fshatrat e 4 NjQV-ve, 5-7 të rinjë të moshës 14-16 vjeç për secilin grup.

1.5. Ekspozitë virtuale për pikat e nxehta. Fotografi dhe video fakte të mbledhura nga ‘Ambasadorët e Natyrës’ do të përmbledhen në një prezantim prej 2-3 minutash, për tu transmetuar në mediat sociale për 3-4 ditë, e promovuar me facebook adds dhe njoftuar si event. Kinemaja e hapur do të shfaq për publikun e gjërë pjesë të ekspozitës, në shesh, para Pallatit të Kulturës.

1.6. Pesë aktivitete vullnetare me grupet rinore dhe komunitetin (burra dhe gra) për të pastruar mbeturinat përgjatë rrugëve rurale dhe promovuar natyrën e pastër. 50-70 nxënës shkolle dhe banorë të komunitetit marrin pjesë në aksionet vullnetare një ditore për të pastruar 5 pikat e nxehta.

1.7. Fushatë ndërgjegjësuese për të rritur vëmendjen dhe pjesëmarrjen në politikat zhvillimore për mbrojtjen e mjedisit, dalje publike në median lokale dhe shpërndaje aktiviteve në rrjeteve sociale.

2.1. Monitorim i menaxhimit të mbetjeve dhe ndikimit që shkakton degradimi mjedisor në ndotjen e ujit, ekosistemin, dëmton dhe zhvillimin e turizmit malor, **dhe publikim i një raporti për situatën me rekomandime.** Një ekspert do të kontraktohet për të mbledhur të dhënat nga terreni, duke u mbështetur në bashkëpunimin e grupeve rinore, gratë & burrat e fshatrave dhe NjQV-ve për të mbledhur të dhëna dhe përgatitur një raport për situatën. Raporti do të publikohet online, ndërsa vetëm 5 kopje do të printohen për 4 NjQV-të dhe 1 kopje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

2.2. Pilotim të grumbullimit dhe evadimit të mbetjeve në fuksion të ndërgjegjësimit, partneritetit dhe aktivizimit qytetar për menaxhimin e mbetjeve, fshati Mustafaj, për 1 muaj, në bashkëpunim me banorët dhe grupet rinore ‘Ambasadorët e Natyrës’, për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në vend-grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë. Do të shpërndahen për çdo familje qese

mbeturinash dhe do të njoftohen që të nxjerrin mbeturinat në qendër të fshatit një herë në javë, për 1 muaj, për tu transportuar (pa kosto nga projekti) nga një mjet transporti në pronësi të bashkisë për në vend-grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë Kukës. Gjatë pilotimit, do të synohet ndërgjegjësimi, edukimi dhe disiplinimi i banorëve dhe ndarja e kësaj eksperience pilotimi me publikun dhe në vecanti me autoritet vendore, si bazë për vazhdimësinë e pilotimit në fshatrat e tjerë.

2.3. Takime konsultative 1 ditore me 10 grupe komunitare dhe përfaqësuesit e 4 NjQV-ve. Në secilën prej NjQV-ve të përfshira në projekt, do të organizohet një takim me 10-14 pjesëmarrës, përfaqësues të krysisë së fshatrave, grupe rinore dhe administratën vendore, duke u siguruar që të ketë të paktën 40% pjesëmarrje të grave dhe vajzave në takime, për të diskutuar dhe konsultuar zhvillimin e planit të veprimit për menaxhimin e mbetjeve.

2.4. Plan veprimi për vazhdimin e projektit i zhvilluar në bashkëpunim me Bashkinë Kukës, NjQV-të, grupet komunitare dhe me grupet rinore, për pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve përgjatë rrugëve rurale. Një ekspert do të kontraktohet për të organizuar anketa dhe 10 fokus grupe me 3-4 drejtues fshatrash, drejtues të 4 NjQV-të, dhe Bashkisë Kukës, me qëllim finalizimin e një Plan Veprimi për vazhdimësinë e aktiviteteve të projektit, që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve të pilotuara në fshatrat e 4 NjQV-ve. Ky aktivitet konsiderohet si vlerë e shtuar e projektit, duke qenë se lidhet me shumicën e aktiviteteve në funksion të menaxhimit të mbetjeve dhe kontribut të drejtëpërdrejtë në mobilizimin komunitar.

2.5. Workshop përmbyllës me të gjithë aktorët dhe bashkëpunorët e projektit: Vlerësimi i projektit dhe ndarja e eksperiencave pozitive, gjetjet e raportit monitorues dhe vazhdimësia e projektit.

d) Kalendari i aktiviteteve

Pasqyrori aktivitetet nëformatin Excel, bashkelidhur, duke dhënë afatet kohore të tyre.

Aneksi 2 : Kalendari i aktiviteteve të planifikuara (bashkangjitur).

2.5 Produktet, Rezultatet dhe Indikatorët

2.5.1 Produktet

- Publikim i raportit për situatën e menaxhimit të mbetjeve dhe ndikimit që shkakton degradimi mjedisor.
- Video-fakt për fushatë ndërgjegjësuese & edukim mjedisor.
- Ekspozite virtuale me fotografi dhe aktivitetet nga terreni.
- Plani veprimit për vazhdimin e projektit

2.5.2 Rezultatet

Ciliështë ndikimi konkret që projekti synon të ketë lidhur me problemet e identifikuara në arsyetimin e projekt-propozimit.

Listoni **rezultatet e pritshme** dhe impaktin/ndryshimin e synuar.

- Reagim konkret nga grupet rinore ‘Ambasadorët e natyrës’ për mbrojtjen e mjedisit dhe pjesëmarrje në vendimmarrje me NjQV-të
- 4 NjQV-të reagojnë & përfshihen në konsultime komunitare duke respektuar barazinë gjinore për të gjetur zgjidhje për menaxhimin e mbetjeve

- Rritet reagimi dhe angazhimi komunitar duke ndikuar në bashkëpunime efektive me autoritetet vendore për qëndrueshmërinë e mjedisit natyror
- Reduktim i ndotjes me 80% në zonën e targetuar dhe promovimi i historive të suksesit në median sociale dhe atë lokale
- Plan veprimi i konsultuar me grupet e interesit nga autoriteteve vendore për vazhdimin e projektit, pastrimin & menaxhimin e mbetjeve
- Drejtuesit e 4 NjQV-ve kuptojë parimet dhe përfitimet e një qasje mjedisore
- Grupet rinore në zonat rurale të fuqizuara dhe aktive ndikojnë në aspektin e mbrojtjes së mjedisit dhe përcaktimin e politikave zhvillimore
- 16.000 banorët e zonës së pilotuar të vetëdijshëm dhe të përfshirë në menaxhimin e mbeturinave

2.5.3 Indikatorët (cilësorë dhe sasiorë).

| Treguesi/Indikator | Situata/Vlera fillestare | Rezultati i synuar |
|---|---|--|
| Krijimi & fuqizimi i 4 grupe 'Amabadorët e Natyrës' | 60 anëtarët e grupeve 'AN', të pa informuar, jo aktiv | 90% e tyre luajnë rol aktiv në komunitet dhe promovojnë natyrën |
| Takime konsultative, 18 grupe komunitare me 4 NjQV-ve për planin e veprimit | Asnjë angazhim komunitar dhe konsultim me NjQV-të për menaxhimin e mbetjeve | 18 fshatra marrin pjesë në konsultime me NjQV-të, ndërsa 10 fshatra zbatojnë planin e veprimit për menaxhimin e mbetjeve |
| Edukimin mjedisor për grupet komunitare | 100% e familjeve të përfshira në ndotjen e ambjentit | 100% e familjeve banorëve nga 4 fshatra zbatojnë planin për grumbullimin periodik të mbeturinave |
| Pastrimin e 5 pikave të nxehta të mbetjeve | 18 pika të nxehta të identifikuara me ndotje | 5 pika të nxehta të pastruara nga ndotja |

2.6 Përfituesit

Përfitues direkt:

- 60 nxënës të moshës 14-16 vjec, nga 4 shkolla të bashkuara të angazhuar në grupet 'Ambasadorët e Natyrës' në NjQV Shishtavec, Topojan, Zapod dhe Bicaj, Bashkia Kukës
- 120 banorët e fshatit Mustafaj, nga pilotimi për grumbullimin dhe evadimin e mbetjeve në fuksion të ndërgjegjësimit, partneritetit dhe aktivizimit qytetar për menaxhimin e mbetjeve, për 1 muaj
- 3700 banorët e fshatrave nga pastrimi mbeturinave i 5 pikave të nxehta
- 24 zyrtarët e NjQV-ve Shishtavec, Topojan, Zapod dhe Bicaj
- 16000 banorët e zonës nga aktivitetet dhe fushata ndërgjegjësuere për edukim mjedisor

Përfitues indirekt:

- 25000 banorët e fshatrave të Bashkisë Kukës, nga hartimi planit të menaxhimit mbetjeve
- 638 nxënësit e shkollave të bashkuara ku zbatohet projekti (Zapod, Topojan, Shishtavec dhe Mustafaj)
- Operatorët turistikë të zonës

- Agjencia e zonave të mbrojtura

Përshkruani nevojat/kërkesatë tyre, si dhe mënyrën se si projekti juaj do t'i adresojë këto nevoja.

Përfituesit e këtij projekti, të cilët janë të rinjë, banorët e zonave rurale dhe autoritetet vendore, kanë shprehur interes gjatë planifikimit të projektit për të kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve, për të minimizuar degradimin mjedisor përgjatë rrugëve dhe rrjedhave ujore në zonat rurale pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik.

Përmes aktiviteteve që nxisin edukimin mjedisor dhe aktivizimin qytetar, projekti u jep mundësi grupeve rinore dhe komunitetit, përfshirë edhe gratë, të organizohen dhe të përfshihen në proceset konsultative, planifikuese dhe vendimarrëse, sikurse edhe aktivitetet vullnetare, duke kontribuar drejtëpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm të ambjentit dhe mobilizim qytetar.

Banorët e zonave rurale të targetuara, kryesisht gratë, dëshirojnë të ndryshojnë situatën e menaxhimit të mbetjeve, pasi çdo ditë merren me pastrimin e mbetjeve. Nryshimi do të ndodhë në një periudhë të shkurtër, me pjesëmarrjen e tyre të barabartë në aktivitetet e projektit.

Organizimi rinor nën grupimin joformal 'Ambasadorët e Natyrës', rritja e njohurive përmes trainimeve dhe përfshirja në aktivitetet vullnetare komunitare është gjithashtu nevojë për të arritur ndryshimin e kërkuar nga grupet komunitare.

2.7 Zona e zbatimit

Projekti zbatohet në Bashkinë Kukës, në 4 Njësi Administrative; Shishtavec, Topojan, Zapod dhe Bicaj, pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik.

2.8 Periudha e zbatimit të Projektit:

Projekti zbatohet brenda një periudhe kohore prej 12 muaj, (1/12/2021 – 30/11/2022)

2.9 Grupi i punës së projektit të propozuar:

Skuadra për zbatimin e projektit përbëhet nga tre profesionistë me eksperiencë dhe tre vajza të reja me energji, eksperiencë në aktivitetet rinore dhe të motivuara (barazi gjinore 50% - 50%).

- Rifat Demalija, Drejtor projekti
- Eris Zenelaj, koordinatorë projekti dhe mobilizuese sociale
- Lavdrim Shehu, asistent finance
- Besjana Gjermiza, eksperte për median, shkrimet PR dhe ekspozitën virtuale
- Shpetim Dulla, ekspert për trainimet & planin e veprimit me autoritetet vendore
- Brusilda Kastrati, lehtësuese për trainimet dhe eksperte ambjentaliste për identifikimin dhe inventarizimin e pikave të nxehta

2.10 Partnerët dhe roli i tyre:

A parashikon projekti të ketë partneritet/bashkëpunime me organizata /individë/pushtetin vendor apo institucione të tjera?

- Bashkia Kukës, zyrtarisht na ka ofruar bashkëpunimin duke marrë pjesë në mënyrë aktive që në përgatitjen e projektit, me një interes të madh për të siguruar se aktivitetet e projektit dhe plani veprimit për menaxhimin e mbetjeve, përveçse do të vazhdojë të zbatohet pas përfundimit të

projektit në këtë zonë, praktikata e mira do të zbatohen në NjQV-të e tjera të Bashkisë Kukës. Skuadra e zbatimit të projektit do të koordinojë aktivitetin me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për kalendarin e pastrimit të pikave të nxehta, dhe grumbullimit periodik të mbetjeve me qëllim që të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

- Drejtuesit e 4 NjQV-ve do të ndihmojnë në organizimin e takimeve konsultative komunitare për zhvillimin e planit të veprimit për menaxhimin e mbetjeve.
- 4 Shkollat e Bashkuara; Topojan, Zapod, Shishtavec dhe Bicaj (9-vjecare & e mesme,) me grupet ‘Ambasadorët e Natyrës’
- Media publike vendore, Radio Kukës, TVSh Kukës janë bashkëpunorët për vizibilitetin
- Bashkëpunorë i mundshëm do të jetë edhe grupi informal (Anxhela Gjana) që ka kaluar konkrusin e idesë me target Bashkia Kukës.

2.11 Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria:

Cilat janë risqet që mund të pengojnë zbatimin e duhur të projektit dhe arritjen e objektivave?

- Mbyllja e shkollave për shkak të COVID-19, mund të jetë një rrezik, për shkak se do të ngadalësonte krijimin e grupeve ‘Ambasadorët e Natyrës’
- Fatkeqsi të natyrore
- Zgjedhjet e parakohëshme vendore

Cilat janë masat që ju planifikoni të ndërmerrni për të përballur pasojat e këtyre risqeve nëse bëhen realitet?

- Do të shfrytëzojmë takimet në vendbanimet e nxënësve dhe platformat online për të fuqizuar Ambasadorët e Natyrës.
- Fleksibilitet për ndryshimin e kalendarit të aktiviteteve pas konsultimeve me donatorin.
- Shfrytëzojmë njohjet dhe lidhjet që kemi krijuar dhe vazhdojmë zbatimin e projektit.

Si mendoni të siguron vazhdimësinë e ndikimit të projektit pas përfundimit të tij?

- Bashkia Kukës është bashkëpunorë kryesor që siguron vazhdimësinë pas projektit, ndërkohë vetë Qendra për Progres Rinor, me eksperiencë dhe aktivitet lokal 20 vjeçar do të vazhdojë me grupet ‘Ambasadorët e Natyrës’ dhe Shkollat të punojmë për fuqizim dhe aktivizim në aktivitete vullnetare komunitare. Pilotimi i evadimit të mbetjeve në partneritet me komunitetin lokal do të mundësojë replikim të praktikave dhe modeleve funksionale.

Ky projekt i propozuar është paraqitur me aprovimin dhe në emër të shoqatës ‘Qendra për Progres Rinor’ Kukës.

Emri dhe nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor të Aplikantit + vula

Data: 30/11/2021

Rifat Demalija



Qendra për Progres Rinor
Center for Youth Progress
KUKËS

Një projekt i Ag



Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



E HAPUR PER SHQIPERINE

